



Raporti i Bankës Botërore "Doing Business 2020", Shqipëria përmirësim në sektorin energjistik

Banka Botërore në raportin e saj "Doing Business 2020" e ka renditur Shqipërinë në vendin e 82-të në rang global, bazuar kjo në një sërë indikatorësh kryesor për zhvillimin e një ekonomie. Vlerësimin më të lartë Shqipëria e ka marrë në furnizimin me energji elektrike, me konkretisht vendi ynë sipas raportit të BB ka ritur qëndrueshmërinë e furnizimit të energjisë përmes zbatimit automatik.

Por në vlerësimin total krahasuar me vitin 2019, sipas ekspertëve të Bankës Botërore, ka një rritje prej 0.7 pikësh, nga 67 pikë që jemi vlerësuar vitin e kaluar.

Renditja e Shqipërisë në këtë raport ka pasur si bazë disa indikatorë, si hapja e një biznesi, ku vendi ynë është i renditur në vendin e 53-të, me një total pikësh prej 91.8; marrja e lejeve të ndërimit, renditur në vendin e 16-të me një total pikësh prej 52.7; furnizimi me energji elektrike, renditur në vendin e 107-të, me një total pikësh prej 71; regjistrimi i pronës, renditur në vendin e 98-të me një total pikësh prej 63.4; mundësia e kredi dhënies, renditur në vendin e 48-të me një total pikësh prej 70, si dhe tregtia e jashtme, renditur në vendin e 25 –të me një total pikësh prej 96.3.

Raportin e plotë të "Doing Business 2020" mund ta lexoni [>këtu<](#)

DHOMA E BIZNESIT TË DIASPORËS SHQIPTARE



Pse është e rëndësishme që bizneset shqiptare të bashkohen në Dhomën e Biznesit të Diasporës

Nga Viola Kalouti - Pak ditë më parë unë duke përfaqësuar biznesin tim "TIS Immigration", Kanada u pranova si anëtare e Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare duke pasur bindjen që mënyra më e mirë për të përhapur dhe rritur biznesin është duke

bërë lidhje. Dhoma e Biznesit të Diasporës ka një reputacion për të mbështetur bashkësinë lokale dhe të Diasporës si dhe ekonominë e saj. Kur biznesi juaj është i lidhur me emrin e kësaj Dome ai jep perceptimin se ju gjithashtu mbështeteni për këto gjëra. Si rezultat, konsumatorët ju besojnë më shumë. Kjo çon në përshtypje më pozitive të biznesit tuaj. Anëtarët e Dhomës, dhe jo vetëm, do të kërkojnë produkte ose shërbime që lidhen me tuajat, do të anojnë më shumë drejt jush, drejt markës "Albania".

Ekspozimi dhe bashkëpunimi, të jep kredibilitetin, hap rrjetin (networkun) dhe mundësinë e lidhjeve B 2 B. >

Çdo dhomë biznesi është unike me përfitimet, burimet dhe mundësitë e saj, sidoqoftë roli dhe qëllimi i tyre është i njëjtë: Të shërbejnë si një zë influence dhe fuqi për të mbështetur, promovuar dhe ritur rrjetin për bizneset lokale dhe të Diasporës.

Ndaj edhe Samitin e parë të Grave në Biznes, i cili u organizua pak ditë më parë në Tiranë, nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, do ta quaj Kuvend të tyre, dhe me besim që do

të ketë vazhdimësi, do ta shihja si një hap të parë drejt realizimit të këtij rrjeti të sipërmarrësve shqiptarë në botë. Një arritje kjo ku u mbledhën gratë sipërmarrëse të biznesit lokal dhe nga Diaspora. Ky Kuvend tregon më së miri se nëse duam zhvillimin ekonomik dhe atë global është i domosdoshëm zbatimi i politikave dhe reformave të brendshme strukturore që çojnë në fuqizimin e gruas duke e parë atë si një aset brilant dhe duke krijuar mundësi të shumta për përfshirjen e tyre.

Duke filluar nga vetja dhe të gjithë atyre që kanë mundësi të investojnë u them se Diaspora me investimet në Shqipëri duhet të jetë katalizatore për rritjen dhe zhvillimin e tregjeve të kapitalit duke ndërrëpunuar me investitorët lokal, duke futur produkte të reja financiare dhe duke siguruar burime të rëndësishme financiare.

Me politikën e drejta vendi ynë mund të tërheq Diasporën të investojë duke lehtësuar kushtet dhe procedurat që jo vetëm tërheqin Diasporën por edhe pasardhësit e tyre

*Autorja është themeluese dhe drejtuese e zyrës ligjore TIS me zyra të saj në 16 vende të botës.



Video: Energjia nga dielli, hapet gara për parkun fotovoltaik në Karavasta

[> Link <](#)



Kompanitë shqiptare të IT tërheqin vëmendjen e investitorëve të huaj

[> Link <](#)

Java në lajme



Ligji i pagesave në Kuvend. Risia, paguan kudo, pavarësisht bankës ku e ke llogarinë

[> Link <](#)



Shefja e FMN-së kërkon që sistemi financiar të bëhet më gjithëpërfshirës

[> Link <](#)

Katër vendime qeverie



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I MINISTRAVE

Gjatë kësaj jave Këshilli i Ministrave ka miratuar katër vendime me rëndësi për zhvillimin e ekonomisë dhe shoqërisë shqiptare. Në mbledhjen e radhës u miratuar vendimi për "Vendimi për organizimin, përbërjen, funksionimin dhe statusin e autoritetit të kontrollit shtetëror të eksporteve, përcaktimin e afateve, të mënyrës dhe të procedurës për shkëmbimin e informacionit dhe të marrjes së mendimit nga institucionet e tjera të përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave të kontrolluara, si dhe përcaktimin e procedurave për lëshimin e garancive dhe kryerjen e kontrollit shtetëror. Ky vendim synon miratimin e statusit, të organizimit, të përbërjes e të funksionimit të Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, afateve, të mënyrës dhe të procedurës për shkëmbimin e informacionit dhe marrjes së mendimit nga institucionet e tjera të përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave të kontrolluara si dhe të procedurave për lëshimin e garancive dhe kryerjen e kontrollit shtetëror.

Një tjetër vendim i miratuar është vendimi për miratimin, në parim, të marrëveshjes ndryshuese, me shkëmbim letrash, të marrëveshjes së huas, ndërmjet republikës së Shqipërisë dhe fondit të Kuvajtit për zhvillimin ekonomik arab, për financimin e projektit "rehabilitimi i rrugës së lumit të Vlorës", ratifikuar me ligjin nr.50/2016.

U miratua gjithashtu edhe vendimi për miratimin, në parim, të ndryshimit nr.3 të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian, në lidhje me programin kombëtar për Shqipërinë, në kuadrin e komponentit IPA "asistenca e tranzicionit dhe mbështetja institucionale" për vitin 2013 (menaxhim i kontrazuar).

Si dhe vendimin për miratimin, në parim, të marrëveshjes ndryshuese, me shkëmbim notash, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin teknik 2017 për projektin "Zhvillim i qëndrueshëm i zonave rurale".

Vendimet e plota të miratuara nga Këshilli i Ministrave mund të lexoni këtu:

<https://kryeministria.al/newsroom/vendime-te-miratuara-ne-mbledhjen-e-keshillit-te-ministrave-date-22-janar-2020>

Kursi zyrtar i këmbimit



Dollar Amerikan	USD	110.42	+0.38
Euro	EUR	121.94	-0.04
Poundi Britanik	GBP	144.66	+0.16
Franga Zvicerane	CHF	113.76	+0.20
Jeni Japonëz (100)	JPY	100.78	+0.34
Dollari Australian	AUD	75.55	-0.04
Dollari Kanadëz	CAD	84.04	+0.44

Rreth Dhomës së Biznesit për Diasporën Shqiptare

Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare është organizata e parë në shërbim të bizneseve të Diasporës. Si një organizatë e pavarur jo-fitimprurëse, ne jemi të perkushtuar të ndihmojmë dhe të nxisim bizneset e të gjitha madhësive për të maksimizuar potencialin e tyre në Shqipëri. Dhoma e Biznesit të Diasporës është një mundësi reale për mbështetjen e investitorëve të Diasporës që dëshirojnë të krijojnë apo të zgjerojnë biznese të tyre në atdhe.



Numrin e radhës të revistës Monitor mund ta lexoni këtu : www.monitor.al

Gazetën Çelësi mund ta lexoni këtu: <http://www.yellowpagesalbania.com>

